

**KONSULTIM ME PUBLIKUN**  
**Aplikim per leje te tipit A**  
**Shoqeria "Green Recycling"**

**Nipt: L31903003N**

**Adresa: Lagja Nr 4, Rruga**  
**Demokracia, Tirane, Kamez**

**GRUMBULLIM, TRANSPORTIM DHE**  
**MAGAZINIM I MBETJEVE**



Bathore, Kamez, Tirana

GREEN RECYCLING S.h.p.k

## I.HYRJE

Mbetjet dhe trajtimi i tyre ne territorin e Shqiperise eshte nje nga problemet e medha mjedisore ndonse ndikimi i tyre ne shendetin e njeriut eshte me i madh se ndotes te tjere. Sidoqofte, mbetjet (solide ose ujore/ujerat e zeza) ndikojne ne komponente te tjere mjedisore si uji, ajri, toka dhe nepermes zinxhirit ushqimor dhe/ose kontaktit direkt me keto eshte mjaft i madh. Mbetjet ndodhen ngado dhe kultura se bashku me mungesen e financimeve dhe sidomos ndergjegjesimi i popullsise dhe rritja e pergjegjesise se autoriteteve lokale mbeten sfida per te ardhmen. Nuk mund te kete produkte bujqesore te pasterta, shendet te mire, burime ujore te pa ndotura, biodiversitet, turizem dhe cilesi jete te larte ne se nuk manaxhohen mbetjet e ngurta dhe ujerat e zeza.

Gjendja ekzistuese e fushave te depozitimit te mbetjeve (grumbullimit) eshte shume shqetesuese jo vetem ne zonen ne studim por ne te gjithe Shqiperine. Ato jane te vendosura pa asnje lloj kriteri per minimizimin e ndikimit ne mjedis, si per sa i perket vendit ku jane vendosur, tipit te ndertimit, si dhe jane pa asnje lloj shtrese papershkueshmerie dhe mbulimi.

Mbetjet e ngurta urbane aktualisht, vetem flaken duke zene siperfaqe te medha toke, ndotin ujrat siperfaqesore, nentokesore, ajrin, token, duke u bere problem teper shqetesues per shendetin e njerezve te atij komuniteti.

Fenomeni i vetedjegies, si dhe i djegies se qellimshme te mbetjeve urbane eshte karakteristike per shume nga vendshkarkimet e mbetjeve te te gjitha rrymave te mbetjeve.

Ndotja e ujrave nentokesore dhe ndotja e ujrave siperfaqesore shkaktohet ose si pasoje e grumbullimit te mbetjeve ne afersi te zonave ujembajtese pa marre masa mbrojtese, ose nga depozitimi dhe hedhja ne ujrat siperfaqesore te mbetjeve.

Grumbullimi me kriter dhe trajtimi me kriter i tyre eshte nje domosdoshmeri per gjenjen kritike qe ndodhet vendi yne.

Shoqeria eshte e pajisur me Leje Mjedisi me 4.07.2015, me nr. Identifikimi 1909 per rikuperimin e mbetjeve jo te rrezikshme.

Shoqeria kerkon te zgjeroje aktivitetin e saj duke shtuar procesin e **grumbullimit, transportimit, magazinimit te mbetjeve te rrezikshme si me poshte:**

1. Mbetje oficine/servisi makinash (psh. Filtra vaji, filtra uji, bateri makine, pjese kembimi, vajrat e perdorur te makinave etj);
2. Mbetje zyre te rrezikshme (monitore, llamba neoni);
3. Vaj vegjetal (vaj per skuqje ushqimesh, vaj shtazor, etj)

Shoqeria mund te permbushe edhe cdo operacion legjitim per tregtimin, ndermjetesimin dhe eksportin e mbetjeve jo te rrezikshme, lendeve te para dhe dytesore dhe te mallrave te perftuara permes trajtimit, riciklimit dhe rekuperimit te mbetjeve jo te rrezikshme ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Me aktivitet rekuperimi kuptohet ai lloj aktiviteti rezultati kryesor i te cilit eshte t'i lejoje mbetjet te kryejne nje rol te dobishem duke zevendesuar materiale te tjetra te cilat perndryshe do te kene qene perdorur per te permbushur nje funksion te vecante ose te pergatiten per te kryer nje funksion te vecante brenda impiantit.

Mbetjet i nenshtrohen nje para-trajtimi qe mund te konsistoje ne perzgjedhje, segmentim, ngjeshje, paletizim, tharje, grirje, kondensim, perpunim, ndarje sipas natyres se tyre dhe destinacionit final.

## II. PERSHKRIMI I TEKNOLOGJISE DHE PROCESIVE QE DO TE SHTOHEN NE IMPJANTIN EKZISTUES

### Mbetjet qe do te grumbullojme:

- Mbetje oficine/servisi makinash (psh. Filtra vaji, filtra uji, bateri makine, pjese kembimi, vajrat e perdorur te makinave etj);
- Mbetje zyre te rrezikshme (monitore, llamba neoni);
- Vaj vegjetal (vaj per skuqje ushqimesh, vaj shtazor, etj)

### Fazat e procesit:

1. Grumbullimi i mbetjeve te prodhuesi i mbetjeve ose mbajtesi i tyre;
2. Transporti i tyre me mjete te autorizuara;
3. Peshimi i mbetjeve ne hyrje;
4. Magazinimi i tyre ne ambientin e brendshem ne zona dhe kontenitore te posatshem ne varesi te llojit te mbetjeve;
5. Dalja e tyre per eksport jashte vendit ne impiante te autorizuar ose shitja e tyre brenda vendit kur eshte e mundur.

### Pershkrimi i procesit:

- **Vaji vegjetal** do te grumbullohet direkt te prodhuesi i mbetjeve ose mbajtesi i tij, p.sh. ne bare, restorante, hotele etj. Do te grumbullohet ne kontenitore me tape hermetik dhe do te transportohet me mjete te autorizuara transporti. Ne momentin qe do te arrije ne ambientin tone, do te peshohet dhe do te hidhet ne kontenitore me te medhenj te pajisur me zgare metalike nga 1 m3 secili dhe te vendosur mbi nje vaske te ngritur nga toka.

Me pas do te magazinohet ne ambientin e brendshem, ne nje zone te posatshme, te mbyllur, te strehuar nga dielli dhe burime ngrohtesie apo agjente atmosferike, por te ajrosur permes dyerve dhe dritareve. Pas grumbullimit te nje sasie prej 20-30 m3, keto kontenitore do te ngarkohen ne kamion dhe do te eksportohen ne impiante te autorizuar per rafinim.



- **Mbetjet e oficines** do te grumbullohen direkt te prodhuesi i mbetjeve ose mbajtesi i tij ne kafaze metalike te ngritura nga toka. Do te transportohen ne kafazet e prodhuesit te mbetjeve ose ne kafazet e tane. Kur te arrijne ne ambientet tona do te peshohen dhe do te magazinohen ne ambientin e brendshem, ne nje zone te posatshme, te ngritura nga toka. Kur te arrihet nje sasi e caktuar do te shiten brenda vendit ose do te eksportohen jashte tij.
- **Vaji i makinave** do te grumbullohet ne fuci te prodhuesi i mbetjeve dhe do te transportohet me mjete te autorizuar transporti. Ne momentin qe do te arrije ne ambientin tone, do te peshohet dhe do te hidhet ne kontenitore me te medhenj te pajisur me zgare metalike nga 1 m<sup>3</sup> secili dhe te vendosur mbi nje vaske te ngritur nga toka. Me pas do te magazinohet ne ambientin e brendshem, ne nje zone te posatshme. Pas grumbullimit te nje sasie te caktuar, keto kontenitore do te ngarkohen ne kamion dhe do te eksportohen ne impiante te autorizuar per rafinim.
- **Monitoret** do te grumbullohen te prodhuesi i mbetjeve, do te transportohen me mjete te autorizuar, ne momentin qe do te mberrijne ne ambientet tona do te peshohen. Me pas do te vendosen mbi paleta dhe do te mbeshtillen me celofan. Pasi te jene vendosur mbi paleta do te magazinohen ne ambientin e brendshem ne nje zone te posatshme. Kur te arrihet nje sasi e caktuar, do te eksportohen jashte vendit ne impiantet e autorizuar.
- **Llambat e neonit** do te grumbullohen te prodhuesi i mbetjeve neper kuti, do te transportohen me mjete te autorizuar, ne momentin qe do te mberrijne ne ambientet tona do te peshohen. Me pas do te magazinohen ne ambientin e brendshem ne nje zone te posatshme neper kontenitore te ngritur nga toka. Kur te arrihet nje sasi e caktuar, do te eksportohen jashte vendit ne impiantet e autorizuar.

- **Baterite** do te grumbullohen te prodhuesi i mbetjeve, do te transportohen me mjete te autorizuar, ne momentin qe do te mberrijne ne ambientet tona do te peshohen. Me pas do te magazinohen ne ambientin e brendshem ne nje zone te posatshme mbi paleta ose ne kontenitore te ngritur nga toka. Kur te arrihet nje sasi e caktuar, do te eksportohen jashte vendit ne impiantet e autorizuar.



Per cdo sqarim mbi kuptimin e operacioneve dhe/ose te kushteve te mesiperme i referohen percaktimeve te legjislacionit perkates ne fuqi dhe, ne mungese, atyre te pershtatura me direktivat e Bashkimit Europian ne fushen e mbetjeve jo te rrezikshme.

Mbetjet jo te rrezikshme te pranuar ne impiant vijne nga burime te ndryshme te tilla si kontribut i drejtperdrejte ne sistem nga qytetaret dhe aktivitete produktive artizanale dhe industriale mbetjet e diferencuara te vetme dhe / ose multi-materiale te bera nga rruga ose "dere me dere" nga bashkite ose subjekte te tjera te autorizuara.

Mbetjet e rrezikshme te pranuar ne impiant do te vijne nga burime te ndryshme te tilla si kontribut i drejtperdrejte ne sistem nga qytetaret dhe aktivitete produktive artizanale dhe industriale, nga mbledhja e diferencuar "dere me dere" nga bashkite ose subjekte te tjera te autorizuara ose terheqja e bere drejtperdrejt nga shoqeria nga prodhuesi apo mbajtesi i mbetjeve.

Do te zbatohen me rigorozitet kerkesat dhe rregullat e percaktuara ne aktet e meposhtme ligjore:

1. **Ligji nr. 10 463, date 22.9. 2011"Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", te ndryshuar;**
2. **VKM nr.175, date 19.1.2011 "Per miratimin e strategjise kombetare te menaxhimit te mbetjeve dhe te planit kombetar te menaxhimit te mbetjeve"**
3. **VKM nr. 371, date 11.06.2014 "Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme"**
4. **VKM nr. 418, date 25.06.2014 "Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve ne burim"**
5. **VKM nr. 229, date 23.04.2014 "Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme"**
6. **VKM nr. 705, datë 10.10.2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"**
7. **VKM Nr. 765, datë 7.11.2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"**
8. **VKM Nr. 866, datë 4.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"**
9. **VKM Nr. 957, datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"**
10. **VKM nr. 575 date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte"**

Pikat e grumbullimit te cilave u dergohen materialet e perpunuara ne fabrike te ndryshojne ne varesi te natyres se mbeturinave dhe perfshijne lloje te ndryshme te industrive te tilla si ato te qelqit, plastikes, aluminit, komponente nga zyra, mullinj letre, perpunimi i materileve te qendrueshme, impiantet e rafinimit te vajrave, impiante te rekuperimit te gazrave etj.

Mbetjet e pa rikuperueshme deroghen per asgjesim ne impiante te autorizuara.

### **Vendndodhja e impiantit**

Shoqeria kryen aktivitetet e saj ne nje zone te pajisur posaçerisht e cila perbehet nga disa zyra dhe nje oborr jashte. Zona e mbuluar eshte 450 m<sup>2</sup>, nderkohe, zbulimi i jashtem, eshte i barabarte me 800 m<sup>2</sup>, me nje sipërfaqe totale prej 1260 m<sup>2</sup>.

Sheshi i jashtem eshte i shtruar ne beton. Kapanoni eshte i shtruar dhe ka nje lartesi qe te lejoje levizjen e automjeteve dhe pajisjeve te nevojshme per trajtimin e mbetjeve.

E gjithë zona eshte e pajisur me gardh rrethues, me mure dhe / ose porta.

Sistemi perbehet nga nje ndertese ne te cilen ndodhin dhe procese dhe trajtime te ndryshme nga nje zone depo / magazine ne te cilen mblidhen si materialet qe jane grumbulluar dhe materialet e perpunuara qe jane gati per t'u derguar ne qendrat e rehabilitimit dhe / apo asgjesimin. Kapanoni disponon edhe disa zyra ne katin e siperm si edhe dhomat e sherbimit ne katin e pare.

### **Tabela: Karakteristikat e stabilimentit**

AMBJENTET	SIPERFAQE m2
ZYRAT (kati i siperm)	160 m2
ZONA E KAPANONIT (kati i pare)	445 m2
ZONA E ZBULUAR	815 m2
TOTALI I SIPERFAQES	1260 m2

Kapanoni eshti i pajisur me energji elektrike, uje, dhe eshte i lidhur me sistemin e kanalizimeve te qytetit. Ai ka nje linje telefonike, ADSL dhe lidhje interneti.



Kapanoni ndodhet pak kilometra nga Tirana. Ai ndodhet ne zonen e Bathores, ne komunen e Kamzes. Zona perreth karakterizohet nga prania e shume vendeve prodhuese, industriale dhe artizanale, por edhe disa hapsirave të gjelberuara ende te paperdorura dhe ndertesa banimi.

Kapanoni eshte perballe rruges dhe kufizohet nga te dyja anet me nje zone te gjelber te pa kultivuar, ndersa ne pjesen mbrapa ka disa ndertesa me nje distance prej disa qindra metra.

Nuk ka infrastrukture te veçante per urbanizim.

Kjo strukture permban 2 banjo, prej te cilave nje eshte ne dispozicion te punetoreve (kati perdhes) dhe një në katin e siperm, e cila shërben per zyrat. Te dyja banjot jane te pajisura me uje te rrjedhshem. Ujrat e zeza jane te lidhur me kanalizimet komunale.

Impianti eshte i ndare ne zona funksionale sic tregohet ne planimetrine bashkangjitur.

Menaxhimi i mbetjeve realizohet si ne pjesen e brendshme ashtu edhe ne pjesen e jashtme te kapanonit ne nje zone te shtruar ne menyre te pershtatshme.

### **III. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI**

#### **Biodiversiteti**

##### **Flora**

Fizionomia floristike e kesaj zone percaktohet nga shkurreta me gjethe gjithnje te blerta dhe nga shkurreta gjethe renese. Ne teresi ne zone vrojtohen afro 350 lloje bimesh te shperndara ne 196 gjini dhe 60 familje. Nje pjese e madhe syresh jane me rendesi ekonomike si bime mjeksore, mjaltore, regjese, helmuese, ushqimore dhe foragjere.

Bimesia ujore e klases phragmitetalia, ku shoqerimi me kryesor eshte ai me kallamishten (phragmites australis). Nje vend te rendesishem ne vegjetacionin e brigjeve te lumit erzen zene pyjet higrofile, te cilet i perkasin kryesisht klasave alno-populetea dhe salicetea purpurea. Ne zonat fushore ku rrjedha e lumit eshte me e qete, ne mjedise me toka aluvionale ranore-argjilore, te cilat permbyten nga uji here pas here gjate vitit, dominon shoqerimi i verriut te zi. Ne katin drunor, pervec alnus glutinosa e fraxinus angustifolia, takohen edhe ulmus minor, populus alba etj.

Ne keto basene ujembledhes rritet nje bimesi ujedashese dhe teper interesante. Ne brendesi te ketyre baseneve ndodhen disa lloje algash makrofite te gjelberta si dhe disa bime fanerogame.

##### **Bimesia e shkurretave mesdhetare**

Shkurretat mesdhetare jane nje nga elementet kryesore perberes te zones se makjes. Ato jane te shtrira pothuajse ne te gjithe hapsiren dhe kryesisht te vendosura ne pjesen e ulet te saj nga lartesia 100- 300 m mbi nivelin e detit. Shkorretat mesdhetare ne kete hapsire perfaqesojne pjesen me kryesore te mbuleses bimore. Vecanerisht pjesa me e madhe e formacionit te makjes ndodhet ne pjesen lindore, jug-lindore dhe jug-perendimore te zones. Kjo lloj bimesie vesh shpatet e kesaj hapsire. Bimesia e kesaj zone perfaqesohet nga makia qe eshte formacioni me karakteristik i bimesise tipike mesdhetare.

##### **Fauna**

Numri i amfibeve te zones eshte 10, afro 60% e llojeve te amfibeve qe jetojne ne shqiperi. Ndersa numri i reptileve te vrojtuar deri me sot eshte 25 lloje, rreth 70% te reptilofaunes qe takohet ne shqiperi. Numri i amfibeve dhe reptileve konsiderohet i larte dhe shpreh gjithashtu shkallen e larte te biodiversitetit te zones.


Nje numer i larte llojesh eshte i rrezikuar ne shkalle kombetare dhe nderkombetare. Nga krahasimi i listes te llojeve te amfibeve e reptileve me listen e kuqe te shqiperise (libri i kuq, 1997) dhe anekset e disa konventave nderkombetare, ne te

cilat shqiperia eshte pale, rezulton se nje numer i konsiderueshem i ketyre llojeve, te pranishme ne zonat kodrinore tirane-durres, u perkasin llojeve te rrezikuara ne nivel kombetar e nderkombetar. Kjo deshmon per rendesine e zones ne studim ne nivel kombetar, mesdhetar e me gjere.

Duhet theksuar se dhjetra ujembledhesit e ndertuar ne kete zone si dhe hapja e shume kanaleve vadites kane krijuar kushte mjaft te favorshme per te gjitha llojet e amfibeve.

## Klima, ajri, zhurmat

*Harta klimatike e zones*



Klima e rajonit eshte mesdhetare fushore qendrore me karakteristikat klimaterike te rajonit te Shqiperise perendimore. Klima e zones se Tiranës eshte mesdhetare e karakterizuar nga nje vere e nxehte dhe relativisht e thate si dhe me dimer te ftohte dhe te lagesht.

Mesatarja vjetore e temperatures se ajrit eshte rreth 15.2°C, ndersa ne vere mesatarja eshte 22-24°C, ndersa ne dimer mesatarja eshte rreth 6-8°C. Mesatarja vjetore e reshjeve luhetet deri ne 1250 mm dhe rreth 70% e saj eshte perqendruar ne periudhen 6 mujore qe fillon nga muaji Tetor deri ne muajin Mars

Ne Shqiperi ererat qe rastisin me shume gjate gjithë vitin jane ato te kuadrantit te veriut dhe pas tyre ato te jugut. Ne perqindje te vogel rastisin ererat perndimore dhe lindore. Ne zonen e Tiranës mbizoterojne ererat me drejtim qendror(39.3%) me pas ato me drejtim juglindje (18.2%), drejtim veriperendim (15.2%), dhe pjesa tjetër varion nen 8%.

Era ne kete zone fryn e lehte gjate periudhes se veres dhe pak me e forte ne dimer. Drejtimi i eres eshte i ndryshem sipas periudhave kohore por ne pergjithsi fryn ne drejtim te veri-perendimit. Shpejtesia e eres varion nga 1-2m2/sek. Zona e Tiranës eshte nje zone me masa ajrore te pa qendryeshme qe shoqerohet me rreshie shiu gjate gjithë perudhes se vitit. Zona eshte e ekspozuar ndaj diellezimit, i mbrojtur nga ererat veriore nga prania e objekteve te banimit

### Cilesia e ajrit

Ne tabelen e meposhteme jepet permbajtja mesatare e disa trguesve te ndotjes se ajrit ne disa pika te Tiranës per vitin 2008(burimi Min e Mjed).

Tabele 1: Vlerat mesatare te treguesve te ajrit per vitin 2008

Stacionet	LNP	PM10	PM2.5	NO2	SO2	O3	Pb
	Ug/m <sup>3</sup>	ug/m <sup>3</sup>	Ug/m <sup>3</sup>	Ug/m <sup>3</sup>	Ug/m <sup>3</sup>	Ug/m <sup>3</sup>	Ug/m <sup>3</sup>
Tirana 1	201.84	104.91	-	51.75	20.63	46.54	0.12
Tirana 2	75.13	42.04	-	18.05	2.98	37.79	0.028
Tirana 3	-	-	-	32.99	13.89	41.06	-
Tirana 4	-	58.38	13.15	-	-	-	0.038
<b>Norma Shqiptare</b>	<b>140</b>	<b>70</b>	<b>15</b>	<b>60</b>	<b>60</b>	<b>65</b>	<b>1</b>
<b>Rekomandimi i OBSH</b>	<b>80</b>	<b>50</b>	<b>-</b>	<b>40</b>	<b>50</b>	<b>65</b>	<b>0.5</b>

Burimi: ISHP, AMP, IFBZ

Kjo situatë dikton nevojën e një plani veprimi "politik" praktik me pjesëmarrjen e aktoreve kryesore që mund të ndikojnë në përmirësimin e kësaj situatë mjedisore. Aktivitetet gjeneruese të ndotjes së ajrit janë shtuar si rezultat i zhvillimeve të disa sektoreve ekonomike, sidomos të transportit, ndërtimit, furnizimit të pamjaftueshëm dhe aritmetik me energji, etj. Ka një cilësi të ajrit nën vlerën kritike të normave të Republikës së Shqipërisë.

Kujtojmë se kontribuesit kryesorë të pluhurit janë shkarkimet e transportit, infrastruktura në rikonstruksion, dhe natyrisht aktivitetet e ndryshme industriale. Përmendim trafikun shumë të rënduar të qytetit të Tiranës

#### ■ Zhurmat.

Sic shihet nga grafiket vlerat e ditës janë në po të njëjtet kufij krahasuar me vitet

Vlerat mesatare të zhurmave për ditën dhe natën për vitin 2008

Qyteti	Vlera mesatare ditën	Vlera mesatare natën
Tirana	70.80	61.80

paraardhës, ndërsa nata reflekton një rritje të ndjeshme të vlerave.

Trafiku është burimi kryesor i kësaj zhurme në mjediset përreth kësaj zone kryesisht urbane, ku konstatohet se nuk ka një mbikalim të normës së lejuar, të cilat janë  $L_{aeq}(ditën) = 52\text{db}(A)$ , ndërsa për  $L_{aeq}(natën) = 42\text{db}(A)$ .

## Gjeomorfologjia

Ekosistemet kodrinore të rajonit nga pikepamja gjeologjiko-tektonike bëjnë pjesë në ultësirën pranë-adriatike. Kryesisht moshat gjeologjike të ekosistemeve kodrinore të rajonit daton që para 15 milion vjetësh (serravalian).

Evolucioni gjeologjiko-tektonik që kanë ndjekur këta rajone, ka kushtëzuar dhe elementet strukturor si : monoklinale, antiklinale, sinklinale , etj.

Nga ana stratigrafike rajoni ndërtohet kryesisht nga depozitime neogjenike. Moshat më të vjetra dhe më të reja gjeologjike të pranishme në rajon janë burdigaliani, langiani, serravalian, tortonian dhe mesinian.

Copetimi horizontal i relievit lëkundet nga 1-5 km/km<sup>2</sup>. Ato rriten në drejtim të pjesës qendrore me të lartë të territoreve argjilore të zonës dhe pranë qendrave të banuar rurale.

Copetimi vertikal i relievit merr vlera te vogla deri ne mesatare, nga rreth 50 ne 200 m/km<sup>2</sup>. Kjo lidhet me perberjen litologjike dhe amplituden jo te madhe te levizjeve ngritese neotektonike. Vlerat me te vogla i takojme ne rrethinat e zones, sidomos ne rrethinat fushore lindore dhe perendimore, ndersa ne ate jugore dhe veriore kane shtrirje shume me te kufizuar. Vlerat me te medha takohen ne qendren me te larte te zones dhe sidomos pergjate fronteve te kuesteve apo kreshtave monoklinale.

Pjerresia e shpateve merr vlera te ndryshme, me te medha (rreth 20-30 %) ne shpatet e sektorit jugor dhe verior si dhe ne frontet e kuesteve e kreshtave monoklinale, ndersa vlerat me te ulta (deri ne 10-15 %) takohen ne rrethinat, sidomos perendimore dhe lindore dhe ne pjesen e poshteme te pellgjeve lumore te zhvilluara ne depozitime argjilore.

Perqindjen me te madhe e zene shpatet me orientim perendimor se bashku me shpatet jugore dhe jugperendimore. Ato jane edhe me te ngrohte, me te dritesuar dhe perbejne oferta te rendesishme per shfrytezimin e tyre per vendosjen e qendrave turistike apo kultivimin e bimeve termofile dhe heliofile.

Ne kete zone perhapjen me te madhe e ka relievi strukturoro-eroziv dhe erozivo-denuedues, te cilet nderthuren ne rrethinat edhe me forma te veçanta te relievit lumor.

Relievi strukturoro eroziv, i lidhur me strukturen monoklinale dhe nderthurjen e formacioneve me fortesi te ndryshme, perbehet nga disa kreshta monoklinale, kueste, siperfaqe dhe lugina strukturore.

Relievi eroziv eshte i lidhur me proceset erozivo – denuduese, te cilat jane nder faktoret kryesore aktuale qe luajne rol te rendesishem ne modelimin e relievit. Intensiteti i tyre eshte i lidhur me kushtet e favorshme natyrore per zhvillimin e proceseve te erozionit dhe shpatit. Nje rol te rendesishem ne zhvillimin e tyre ka luajtur aktiviteti i njeriut mbi mjedisin dhe sidomos mbi bimesine dhe tokat ne veçanti.

### **Tipi i tokave ne zone dhe perdorimi i tyre**

Tokat ne kete zone jane te hinjta kafe dhe te kafenjta. Ato shtrihen ne formen e brezave vertikale deri ne lartesine me te medha te zones.

Sic shihet edhe ne pamjen satelitore te truallit, siperfaqja e kerkuar dhe zona perreth eshte teresisht e zhveshur nga bimesia natyrore dhe eshte e shfrytezuar pergjithesisht si toke bujqesore.

Ky ekosistem ze nje pjese te mire te kesaj hapsire dhe ne pjesen me te madhe shtrihet ne zonen e ulet dhe kryesisht prane zonave te banuara. Ai perfaqesohet kryesisht nga tokat e mbjella me kultura te ndryshme bujqesore dhe nga pemet drufutrore te cilat jane mjaft te perhapura ne kete hapsire.

Flora e tokave te kultivura eshte ne pergjithesi e varfer dhe monofite, e perfaqesuar kryesisht nga te lashtat dhe kulturat prashitese.

Kultura e ullirit ne kete hapsire ze nje siperfaqe te konsiderueshme dhe eshte e perhapur pothuajse ne te gjithe zonen, nga lartsite 100-400 m.

### **Siperfaqet boshe**

Keto habitate ne kete zone zene siperfaqe te vogla dhe jane kryesisht ne pjerrsit e kodrave, te perfaqesuara nga pjeset shkembore dhe pjeset e eroduara. Keto siperfaqe jane pothuajse teresisht te xhveshura nga bimesia fanerogamike. Ne siperfaqet shkembore takohen kryesisht perfaqesues nga flora likenike, briofitike dhe nga disa pteridofite.

## IV. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE

Zona e projektit ben pjese ne basenin uJOR Ishem-Erzen. Baseni UJOR i Lumit Ishëm-Erzen ndodhet në Shqipërinë e Mesme dhe ka një sipërfaqje me lartësi të ulët prej 1.439 km<sup>2</sup> (Lushaj dhe të tjerë, 2016), që mbulon Qarqet e Tiranës dhe Durrësit, të dy me më shumë se një milionë banorë. 98% e familjeve në Qarkun e Tiranës dhe 96% e familjeve në Qarkun e Durrësit janë të pajisura me sisteme të furnizimit me ujë. Ishëm-Erzeni përbëhet nga dy nën-ujëmbledhës kryesorë: Lumi Ishëm që përshin lumin e Tiranës dhe Lumin e Lanës dhe Lumi Erzen.



*Baseni uJOR Ishem-Erzen.*

Ne zonen e ngushte te projektit verehet se nuk ka burime siperfaqesore dhe perreth saj nuk ka zona te lundrueshme dhe nuk ndodhen lumenj, liqene dhe dete, prandaj gjate shfrytezimit nuk do te cenohen rruget uJore, brigjet lumenjte, dhe bregdetet etj.

I vetmi burim uJOR siperfaqesor me prane zones se objektit eshte perroi i Gjokajt.

Nderthurja e pakove ranore e konglomeratike me ato argjilore i ka dhene mundesi grumbullimit ne sasira te konsiderueshme te ujerave nentokesore (akuiferet e tortonianit, mesinianit dhe kuaternarit). Per kete flasin puset e shumta te hapura kohet e fundit nga vete fermeret dhe puset e thella te hapura nga hidrogjeologjia para vitit 1990, qe furnizonin te gjitha qendrat e banuara me uje te pijshem nepermjet ujesjellsave te ndertuara ne vite te ndryshem. Per fat te keq keta ujesjellsa aktualisht nuk funksionojne, prandaj edhe fermeret jane detyruar te hapin vete puse te ceket (deri 10 m) per te siguruar ujin per nevojat e tyre. Kjo pasuri jo e vogel, ne kushtet kur ne siperfaqe, siç theksuam, rezervat uJore jane teper te



kufizuara, duhet te vleresohet ne strategjite dhe planet e zhvillimit te qendrueshem te zones.

## **V. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME, NEGATIVE, NE MJEDIS, TE PROJEKTIT**

Aspektet kryesore mjedisore qe duhet te merren parasysh ne lidhje me aktivitetet e saj ne faqen e internetit jane:

- ✓ Konsumi i lendeve te para dhe materialeve ndihmese
- ✓ Konsumi i ujit
- ✓ Konsumi i energjise
- ✓ Derdhjet e lengshme
- ✓ Mbeturinat
- ✓ Zhurma
- ✓ Substanca te rrezikshme
- ✓ Emisionet ne atmosfere

Ajo qe duhet te theksohet eshte se aktiviteti ka nje ndikim te kufizuar mbi receptoret kryesore mjedisore te tilla si, ajri, toka, uji dhe mjedisin. Aktiviteti nuk perfshin konsumin e lendeve te para dhe materiale ndihmese. Uji nuk eshte perdorur ne ciklin e prodhimit. Eshte perdorur ne nje menyre te kufizuar per te lare disa materiale te dhena, nese eshte e nevojshme, dhe periodikisht ambientet e magazines dhe zona jashte, si dhe per sherbimet higjenike. Rrjedh ne sistemin e kanalizimeve te qytetit. Ka derdhur nje elektrik te ndertuar ne perputhje me legjislacionin ekzistues. Kapaciteti i sistemit eshte teresisht i mjaftueshem per te permbushur nevojat energjetike te perpunimit dhe trajtimit te parashikuar.

Energjia e konsumuar eshte e formuar nga keto dy komponente:

- Energjia elektrike, konsumohet kryesisht nga zyrat per funksionimin e pajisjeve elektrike dhe sistemeve, per ndricim te jashtem dhe te brendshem, per funksionimin e makinerive dhe pajisjeve ne stabiliment;
- nafte per automjetet pushtet te tilla si karrelo ne perdorim ne fabrike dhe per automjetet qe kryejne sherbimin e jashtem te mbledhjes se mbeturinave. Aktivitetet e renditjes dhe perzgjedhja e llojeve te ndryshme te mbeturinave te listuara nuk do te perfshije formimin e rrjedhave dhe / ose gjenerimi i shkarkimet lengeta apo emisionet ne atmosfere. Cikli i prodhimit nuk parashikon prodhimin e mbeturinave te rrezikshme.

Mbetjet jo konform dhe mbetjet e klasifikuara dhe te perzgjedhura dergohen per asgjesimin ne qendren e sherbimit te autorizuar, sipas legjislacionit ne fuqi. Lidhur me gjenerimin e zhurmes, kompania eshte e vendosur ne nje zone me popullsi te pakte, dhe atehere rreziku i shkaktuar deme ndaj fqinjëve eshte shume e ulet .

## **Vleresimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin natyror dhe ate social**

Perpare se te identifikojme ndikimet e mundshme negative ne mjedis nga veprimtaria e mesiperme dhe aktiviteti qe do te kryhen ne kompleks **duhet te theksojme se** shoqeria angazhohet te kontrolloje, monitoroje dhe beje perpjekje te vazhdueshme per te minimizuar ne maksimum cdo efektet negative sado minimal ne mjedis nga veprimtaria e saj.

